

VENDIM
Nr. 4, datë 15.1.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 15.1.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (J) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Jamarbër Malltezi, përfaqësuar nga avokatët Klodjan Skënderaj dhe Sokol Mëngjesi, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Arben Kraja, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 400, datë 30.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 172 (87-2024-248), datë 13.9.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-2076, datë 17.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 17, 18, 27, 28, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, paragrafi 1, shkronjat “b” dhe “c”, 8, 10, 14, 17 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 9, 14 dhe 26 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të ratifikuar me ligjin nr. 7510, datë 8.8.1991; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit Jamarbër Malltezi (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Mbi bazën e një kallëzimi penal, në datën 1.12.2020 Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 287 të vitit 2020 (*procedimi penal nr. 287/2020*) për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287, paragrafi i parë, i Kodit Penal (KP), ndërsa në datën 2.10.2023 ka shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, krahas emrave të shtetasve S.B. (vjehtëri i kërkuesit dhe njëkohësisht ish-Kryeministër), F.B. dhe Xh.B., edhe emrin e kërkuesit, në cilësinë e personit të dyshuar për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 260 e 25 të KP-së dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i KP-së. Objekt i kallëzimit dhe hetimit në vijim kanë qenë proceset e kthimit të pronës në favor të 5 familjeve ish-pronare, procesi i privatizimit të pronës shtetërore (të objekteve të ish-klubit sportiv “Partizani” dhe ish-klubit shumësportësh “Partizani” në Tiranë), procesi i ndryshimit të destinacionit dhe, më pas, edhe i zhvillimit të pronës.

2. Në datën 16.10.2023 Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) me kërkesë për caktimin ndaj kërkuesit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”. Me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur pranimin e saj, ndërsa me vendimin nr. 116, datë 23.10.2023, ajo ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në burg”. Mbi ankimin e kërkuesit, me vendimin nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) ka vendosur ndryshimin e vendimeve të GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe caktimin ndaj kërkuesit të masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”. Në vijim, mbi rekursin e kërkuesit dhe Prokurorisë së Posaçme, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-384, datë 5.3.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tyre. Ky proces është bërë objekt i kontrollit kushtetues nga Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), e cila, me vendimin nr. 83, datë 5.12.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

3. Ndërkohë që çështja ishte në shqyrtim në Gjykatë, në datën 28.6.2024 Prokuroria e Posaçme, bazuar në nenin 246, pika 6, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka paraqitur në GJKKO-në e Shkallës së Parë informacionin me shkrim, në të cilin pasi pasqyroheshin veprimet hetimore të kryera nga Policia Gjyqësore, shprehej se masa e sigurimit duhet të vazhdojë. Në seancën e datës 19.7.2024, kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësve të tij, ka kërkuar revokimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, bazuar në nenin 261, pika 1 të KPP-së, me argumentin se nga hetimi nuk ka asnjë provë të re në raport me akuzën që i atribuohet kërkuesit.

4. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 400, datë 30.7.2024 (*vendimi nr. 400/2024*), ka vendosur vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në shtëpi”, të caktuar ndaj kërkuesit me vendimin nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023 të GJKKO-së së Apelit. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, pas caktimit të masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, nga ana e organit të akuzës janë kryer veprime hetimore të cilat pasqyrojnë se është treguar diligenca e duhur në ushtrimin e ndjekjes penale. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi dhe i hetuari tjetër S.B.

5. GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 172 (87-2024-248), datë 13.9.2024, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 400/2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Sipas GJKKO-së së Apelit, vendimmarrja e GJKKO-së së Shkallës së Parë është e bazuar në fakt dhe në nevojat e sigurimit të kërkuesit ose mbajtjen në kontroll paraprak të rrezeve të mundshme të procedimit nga lënia në liri ose pa masë sigurimi, mbeten të qëndrueshme. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2076, datë 17.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuar nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, të dyja gjykatat kanë argumentuar vendimmarrjen e tyre dhe u kanë dhënë përgjigje në thelb shkaqeve të parashtruara nga mbrojtja e kërkuarit dhe arsyetimet e tyre janë plotësuese të njëra-tjetrës.

7. Në datën 11.6.2025 kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës në datën 29.7.2025 ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 12.9.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Me vendimin e po kësaj date Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur respektivisht pranimin e kërkesës së një gjyqtareje kushtetuese për heqjen dore nga gjykimi i çështjes, si dhe rrëzimin e kërkesës për dorëheqje të një gjyqtari tjetër nga shqyrtimi i çështjes.

8. Gjithashtu, rezulton se në datën 17.6.2025 kërkuari ka paraqitur në GJKKO-në e Shkallës së Parë kërkesë për revokimin e masës së sigurimit personal dhe zëvendësimin e saj me masën e sigurimit “Garancia pasurore”. Kjo gjykatë, me vendimin nr. 404, datë 7.7.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për revokimin e masës së sigurimit, pranimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në shtëpi”, të caktuar ndaj kërkuarit me vendimin nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023 dhe zëvendësimin me masën e sigurimit personal “Garancia pasurore”, të parashikuar nga neni 236 i KPP-së.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar liria personale:

A. Në aspektin procedural – e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

9.1. Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi gjyqtarja I.Gj., e cila ka dhënë vendimin në gjykatën e shkallës së parë, është dënuar për kryerjen e një veprë penale dhe në referim të dispozitave të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 96/2016), gjyqtari i cili rezulton i dënuar humbet statusin e magjistratit. Kërkuari ka marrë dijeni për provat që mbështesin këtë pretendim në datën 5.5.2025 dhe në seancën gjyqësore paraprake të po kësaj date ka kërkuar kohë për paraqitjen e kërkesës për pavlefshmërinë e vendimit nr. 400/2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Po ashtu, për të njëjtën arsye, kërkuari i është drejtuar edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) me kërkesë për mbarimin e statusit të magjistratit të gjyqtarës I.Gj., i cili e ka vlerësuar të panevojshme kryerjen e verifikimeve për këtë fakt. Kërkuari e ka përsëritur kërkesën për pavlefshmërinë e vendimit nr. 400/2024 në seancën e datës 19.5.2025 dhe kërkesën drejtuar KLGJ-së në datën 22.5.2025, si dhe ka paraqitur kallëzim penal.

9.2. Parimit të paanshmërisë, për shkak të sjelljes së gjyqtarës I.Gj., konkretisht për faktin se ajo nuk ka zbatuar afatet procedurale të parashikuara nga ligji, pasi ka bërë një trajtim të ndryshëm të kërkesave të paraqitura nga kërkuari në raport me kërkesat e paraqitura nga organi i akuzës, ndërsa mosrespektimi i afateve procedurale nuk shoqërohet me ndonjë pasojë. Kjo gjyqtare ka vlerësuar më parë, me vendimin nr. 116/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, se afati dyditor është i mjaftueshëm për mbrojtësit e kërkuarit që të njihen me 42 fashikuj dhe një vendim gjyqësor prej 200 faqesh. Ndërkohë, organit të akuzës i ka dhënë 11 ditë kohë për të lexuar një material prej jo më shumë se 50 faqesh të relatuar nga mbrojtësit e kërkuarit në seancë, i cili ishte mbështetur në informacionin e vetë organit të akuzës. Gjyqtarja I.Gj. ka ndryshuar vendimin e saj të

ndërmjetëm sipas opinionit të Prokurorisë së Posaçme, ku fillimisht nuk ka pranuar që kërkuesi të marrë kopje falas të akteve, ndërsa pasi prokuroria ka pranuar të japë këto akte, ajo është shprehur se shpenzimet mbuloheshin nga shteti. Opinioni i kësaj gjyqtareje ndryshon sipas opinionit juridik të prokurorisë, duke dëshmuar njëanshmërinë e saj dhe duke e vendosur kërkuesin në pozita procedurale jo të barabarta me organin e akuzës.

9.3. *Së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje kërkuesit në lidhje me pretendimet e ngritura prej tij për cenimin e të drejtave dhe lirive themelore. Gjykatat nuk kanë përmbushur detyrimin e verifikimit të gjendjes së hetimit, por janë kufizuar në listimin e veprimeve të Prokurorisë së Posaçme. Kërkesa për revokimin e masës së sigurimit është paraqitur megjithëse nuk ka ekzistuar nevoja e sigurimit, nuk ka të dhëna se kërkuesi mund të ketë ndikuar në procesin e marrjes ose vërtetësisë së provave dhe nuk ekziston rreziku i largimit. Arsyetimet e gjykatave janë kontradiktore dhe të pakuptueshme, të përdorura edhe në caktimin e masës së sigurimit një vit më parë. Gjykatat nuk kanë arsyetuar pse është i pabazuar kërkimi i kërkuesit për detyrimin e gjykatës që të verifikojë diligjencën e duhur të organit të akuzës. Po kështu, gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesit se roli i tyre është verifikimi nëse prokuroria ka argumentuar nevojat e kryerjes së veprimeve hetimore në afate të shpejta. Veprimet e prokurorisë për kryerjen e ekspertimeve grafike janë të paarsyetuara, pasi ajo nuk ka argumentuar nevojën e marrjes së këtyre të dhënave dhe lidhjen me hetimin. Vendimet janë të pavlefshme, pasi vijnë në kundërshtim me nenet 179 dhe 181 të KPP-së, për faktin se ato nuk janë kryer nga ekspertë, si individë, por nga Instituti i Policisë Shkencore, i cili është në varësi të ministrit të Brendshëm, kallëzues në procedim, si dhe nga persona të panjohur për kërkuesin. Këto pretendime nuk janë shqyrtuar nga gjykatat dhe ligjshmëria e marrjes së provave nuk mund të kufizohet vetëm tek gjyqtari i seancës paraprake. Asnjë nga gjykatat nuk është ndalur në ndonjë provë konkrete, por kanë përdorur shprehje standarde dhe një qëndrim formal, veçanërisht gjykata e apelit, e cila është mjaftuar me një paragraf në arsyetimin e saj.

B. Në aspektin substancial në drejtim të:

9.4. *Mungesës së faktit penal*, në cenim të nenit 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, pasi gjykatat nuk mund të arsyetojnë se pas 4 vjetësh hetimesh ka rezultuar se fakti penal ka të bëjë me propozimin dhe miratimin e ligjeve dhe akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave i drejtuar nga vjehri i kërkuesit, veprimtari nga e cila nuk ka qenë vetëm ky i fundit që ka përfutur procesin e njohjes, kthimit dhe privatizimit të pronës, por mijëra subjekte private. Gjykatat nuk duhet të lejojnë pas 4 vjetësh hetime që dyshimi i prokurorisë të mbështetet në të njëjtin nivel “arsyeje”. Veprimet e kryera nga vjehri i kërkuesit, për të cilat pretendohet se ka përfutur ai, janë veprime të parashikuara në Kushtetutë, konsiderohen akte kolegjiale dhe që janë kryer për shkak të detyrës që ai ka pasur si Kryetar i Këshillit të Ministrave.

9.5. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi gjykatat nuk kanë dhënë argumente të mjaftueshme për nevojën e kohëzgjatjes së arrestit në shtëpi dhe vazhdimin e kufizimit të lirisë personale dhe së drejtës për jetë familjare. Gjykatat nuk e kanë mbështetur arsyetimin e tyre në të dhënat që kanë rezultuar nga hetimi, pasi nga asnjë provë nuk rezulton përpjekja e vjehrit të kërkuesit për të ndikuar në procesin e marrjes së provave. Pas 4 vjetësh hetime dhe 10 muajsh arrest në shtëpi, gjykatat duhet të japin argumente të mjaftueshme, bazuar mbi të dhënat e hetimit. Faktet e dyshuara penale kanë ndodhur në vitin 2013, ndërsa masat e sigurimit janë kërkuar në vitin 2023 dhe prokuroria nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për sigurimin e provave për dëshmitarët, nuk ka konstatuar asnjë veprim që do të ndikonte në procesin e marrjes ose vërtetësisë së deklarimeve të dëshmitarëve, si dhe nuk ka provuar se kërkuesi mund të largohet. Gjykatat nuk kanë paraqitur arsye legjitime të mjaftueshme për vazhdimin e kufizimit të lirisë së kërkuesit, në

drejtim të nevojshmërisë dhe proporcionalitetit të masës, në raport me fazën aktuale të procedimit dhe të dhënave të prokurorisë të vëna në dispozicion.

9.6. *Parimit të mosdiskriminimit* të lidhur me *tejkalimin e qëllimeve për të cilat lejohen kufizimet e të drejtave dhe nenin 18 të KEDNJ-së*, pasi ndjekja penale është shtyrë nga motive politike dhe në gjykatën e apelit kërkuesit i është ndërprerë fjala dhe nuk i është lejuar marrja e provave, si dhe paraqitja e pretendimeve për motivin politik të procedimit penal. Ky motiv provohet qartësisht nga sjellja e autoriteteve, pasi kërkuesit iu ndalua çdo lloj komunikimi me botën e jashtme dhe anëtarë të familjes, si dhe e drejta e ajrimit, tregues të mënyrës së trajtimit të tij nga gjykatat. Vjehri i kërkuesit është kryetar i partisë më të madhe opozitare, ndërsa kallëzimi penal është paraqitur nga kryetari i grupit parlamentar të partisë në pushtet.

9.7. *Parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi gjykatat kanë mbajtur standard të dyfishtë për kërkuesin në krahasim me shtetas të tjerë. Për Prokurorinë e Posaçme, kërkuesi mban përgjegjësi penale si në rastin kur vjehri i tij ka qenë në rolin e përfaqësuesit të organit propozues të akteve ligjore, ashtu edhe në rastet kur ai ka qenë në rolin e drejtuesit të organit që ka shqyrtuar propozimin e një subjekti tjetër. Edhe Gjykata nuk ka shqyrtuar pretendimet e kërkuesit për mungesën e ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm, duke iu referuar gjykimit të themelit, qëndrim i ndryshëm me raste të tjera, si p.sh. vendimi nr. 86, datë 30.12.2024. Po kështu, Gjykata ka trajtuar ndryshe edhe rolin e vjehrit të kërkuesit si kryetar i ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në marrjen pjesë dhe vendimmarrjen për akte kolegjiale individuale, me rolin e tij në marrjen pjesë dhe vendimmarrjet për akte kolegjiale normative.

10. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

10.1. Pretendimet e kërkuesit për aspektin procedural në drejtim të cenimit të *parimit të paanshmërisë dhe së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* janë të pabazuara, pasi vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), i referuar prej tij, pasqyron procesin ligjor të gjykatave vendase në rastin e gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit L.D., që përfundoi me vendimin e Komisionit Disiplinor sipas parashikimit të nenit 128, pika 2, shkronja “b”, të Kushtetutës, ndaj rrethana e pretenduar nga kërkuesi është jashtë kufijve të shqyrtimit në këtë gjykim kushtetues. Këto pretendime janë ngritur edhe në një gjykim tjetër të zhvilluar nga Gjykata, e cila, me vendimin nr. 42, datë 1.7.2025 (*vendimi nr. 42/2025*), ka arsyetuar se nuk ka ndonjë akt të organit publik të ngarkuar nga ligji që të ketë vendosur për ndalimin e ushtrimit të funksionit nga gjyqtarja I.Gj. për shkakun e pretenduar. Në këtë kuptim, gjyqtarja, ndërsa ka qenë në detyrë, ka vepruar në kushte legjitimiteti në ushtrimin e funksioneve në rastin konkret.

10.2. Pretendimet e kërkuesit për aspektin substancial të lirisë personale janë të pabazuara, pasi referuar jurisprudencës së Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, dyshimet e arsyeshme për kryerjen e veprës penale, që justifikojnë kufizimin e lirisë personale, nënkuptojnë ekzistencën e fakteve dhe informacioneve, të cilat nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato që justifikojnë dënimin penal. Në arsyetimin e saj Gjykata e Lartë e ndërlihd statusin e gjësë së gjykuar, për sa kohë nuk janë verifikuar/konstatuar ndryshimet e kushteve origjinare të zbatueshmërisë së masës së caktuar. Në rastin konkret, nga gjykatat e të gjitha shkallëve është respektuar kriteri kushtetues i dyshimit të arsyeshëm, si kusht *sine qua non* për justifikimin e kufizimit të lirisë personale të kërkuesit. Nga gjykatat është arsyetuar mjaftueshëm në lidhje me plotësimin e kushteve të veçanta për caktimin e masës së sigurimit, rrezikut të ikjes së personit dhe rrezikut të ndërhyrjes së tij në marrjen e provave.

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesës

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si edhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata konstaton se objekt i këtij ankimi kushtetues individual janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjyimit që kanë disponuar për informacionin dymujor të Prokurorisë së Posaçme, duke vendosur vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, proces gjatë të cilit kërkuesi ka kërkuar revokimin e kësaj mase. Në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues (11.6.2025) kërkuesi vijonte të ishte nën këtë masë sigurimi, që është shuar në vijim me vendimin e datës 7.7.2025 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, e cila ka vendosur ndaj tij masën e sigurimit të garancisë pasurore. Megjithatë, pavarësisht se në momentin e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual masa e sigurimit është zëvendësuar me një masë më të lehtë, kërkuesi e mbart ende statusin e viktimës, pasi gjykatat e zakonshme nuk e kanë njohur/korrigjuar shkeljen e së drejtës që pretendohet se është shkelur. Sikurse ka pohuar edhe Gjykata në vendimmarrjen e saj, ndryshimi i nevojave të sigurimit, për pasojë vendimet gjyqësore që ndryshojnë masat e sigurimit *in melius*, nuk mund të konsiderohen si korrigjime të shkeljes së pretenduar (*shih vendimin nr. 1, datë 17.1.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, pavarësisht se masa e sigurimit e kundërshtuar nga kërkuesi “Arresti në shtëpi” nuk është më në fuqi për shkak të ndryshimit të saj dhe, për rrjedhojë, vendimet objekt kërkesë nuk sjellin më pasoja ndaj tij, kjo nuk ndryshon faktin se kërkuesi ka qenë duke vuajtur një masë heqjeje të lirisë, për të cilën ai pretendon se është jokushtetuese dhe në kundërshtim me liritë dhe të drejtat e tij. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* si në aspektin procedural, ashtu edhe atë substancial, pasi jo vetëm ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, por provon edhe interesin e drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

13. Për sa i takon kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, individit mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim individual kushtetues vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Detyrimin për përmbushjen e këtij kriteri Gjykata e ka vlerësuar si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur në themel procesin gjyqësor, ashtu edhe në rastin e vendimeve të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Për sa u takon këtyre të fundit, Gjykata ka pranuar se vendimet gjyqësore për caktimin e masës të sigurimit personal me karakter shtrëngues që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, i bëjnë ato vendime përfundimtare në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Si të tilla, Gjykata në jurisprudencën e saj ka konsideruar si masat e sigurimit personal “Arresti në burg” (*shih vendimet nr. 83, datë 5.12.2024; nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*), ashtu edhe “Arresti në shtëpi” (*shih vendimet nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 75, datë 22.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, gjithashtu, ka marrë

në shqyrtim edhe vendimet gjyqësore të dhëna në lidhje me kërkesat për zëvendësimin e masave të sigurimit (*shih vendimin nr. 40, datë 14.5.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret Gjykata vëren se objekt i ankimit kushtetues individual janë vendimet gjyqësore që kanë vlerësuar informacionin dymujor të Prokurorisë së Posaçme në kuadër të procedimit penal nr. 287/2020 ndaj kërkuesit, bazuar në nenin 246, pika 6, të KPP-së, i cili parashikon se çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori informon me shkrim gjykatën që ka caktuar masën për hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit dhe gjykata, pasi dëgjon palët, vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit. Për shkak të natyrës së ndërmjetme, jo përfundimtare, të këtyre vendimeve, si dhe periodicitetit të tyre, për sa kohë ato janë dhënë në kuadër të një procedimi penal që është ende duke u zhvilluar, do të analizohet në vijim nëse përjashtimisht ato mund të konsiderohen përfundimtare për ushtrimin e kontrollit kushtetues ndaj tyre.

15. Në referim të standardeve kushtetuese të mësipërme, Gjykata konstaton se vendimet gjyqësore të kundërshtuara nëpërmjet këtij ankimi kushtetues, për sa kohë kanë disponuar për vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në shtëpi”, rezultojnë të kenë vendosur kufizime mbi të drejtat e kërkuesit të pretenduara të cenuara dhe janë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimeve të ndërmjetme të kundërshtuara prej tij, pra ai ka arritur të provojë se është viktimë e shkeljes të të drejtave kushtetuese dhe i ka kundërshtuar ato në të gjitha shkallët e gjykimit. Po kështu, ato kanë një masë autonomie nga procesi i themelit, pasi vendimi përfundimtar nuk mund të riparojë efektin e tyre. Për rrjedhojë, pavarësisht faktit se këto vendime gjyqësore kanë natyrë periodike, pasi dalin bazuar në detyrimin e prokurorit për të informuar çdo dy muaj gjykatën për hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit, Gjykata evidenton se ato konsiderohen përfundimtare në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe 71/a, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit Organik të Gjykatës.

16. Po në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka theksuar se ai kërkon që pretendimet që parashtrihen përpara kësaj Gjykate të jenë paraqitur më parë në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata vëren se kërkuesi, në aspektin formal, i është drejtuar asaj me ankim kushtetues, pasi ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit përpara gjykatave të zakonshme të të tria shkallëve të gjykimit. Për sa i përket aspektit substancial të këtij kriteri, kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e *parimit të mosdiskriminimit* të lidhur me *tejkalimin e qëllimeve për të cilat lejohen kufizimet e të drejtave dhe nenin 18 të KEDNJ-së*, me argumentin se ndjekja penale është shtyrë nga motive politike. Po kështu, ai ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*, me argumentin se gjykatat kanë mbajtur standard të dyfishtë për kërkuesin në krahasim me shtetas të tjerë. Në lidhje me këto pretendime, referuar kërkesës dhe materialeve bashkëlidhur, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk i ka ngritur ato në rekursin e paraqitur pranë Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në aspektin substancial për këto pretendime, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata.

18. Kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, i datës 17.12.2024, i është komunikuar mbrojtësit të kërkuesit në adresën e tij të postës elektronike në datën 24.2.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 11.6.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

19. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e lirisë personale si në aspektin procedural në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor për sa i përket: i. *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*; ii. *parimit të paanshmërisë*; iii. *së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*; ashtu dhe në aspektin substancial në drejtim të: i. *mungesës së faktit penal*; ii. *standardit të arsyetimit për sa i përket mungesës së argumenteve për nevojën e vazhdimit të masës së sigurimit*; iii. *proporcionalitetit të kufizimit të të drejtave*. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për jetë familjare, të garantuar nga neni 36 i Kushtetutës.

20. Për sa i përket pretendimit të fundit, Gjykata vëren se ai është paraqitur nga kërkuesi edhe në ankimin kushtetues individual të datës 26.6.2024, për të cilin, me vendimin nr. 83/2024, Gjykata, në referim edhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së, ka vlerësuar se kërkuesi nuk ka arritur të provojë cenimin e së drejtës për jetë familjare në aspektin kushtetues, në kuptim të marrëdhënieve familjare konkrete të cenuara për shkak të caktimit ndaj tij të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”. Për rrjedhojë, Gjykata, me të njëjtin arsyetim si në vendimin nr. 83/2024, vlerëson se edhe në këtë rast ai nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi gjyqtarja I.Gj., e cila ka disponuar me vendimin në gjykatën e shkallës së parë, është dënuar për kryerjen e një vepre penale dhe për këtë shkak ajo ka qenë në kushtet e mbarimit të statusit të magjistratit. Sipas kërkuesit, ai i është drejtuar edhe KLGJ-së, e cila e ka vlerësuar të panevojshme kryerjen e verifikimeve për këtë fakt.

22. Në rastin konkret, Gjykata evidenton se çështja që ngrihet nga kërkuesi ka të bëjë me faktin se gjyqtarja I.Gj. ka qenë në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit për shkak të ligjit, ndaj ushtrimi i tij në rastin konkret ka cenuar të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Megjithatë, Gjykata vëren se nuk ka ndonjë akt të organit publik të ngarkuar nga ligji që të ketë vendosur për ndalimin e ushtrimit të funksionit nga ajo gjyqtare për shkakun e pretenduar nga kërkuesi ose për ndonjë shkak tjetër ligjor. Në këtë kuptim, gjyqtarja në fjalë, ndërsa ka qenë në detyrë, në kushtet kur nuk është provuar e kundërta, ka vepruar në kushte legjitimiteti në ushtrimin e funksioneve dhe, për pasojë, pretendimi i kërkuesit është qartazi pa bazë ligjore. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar *ratione materiae*.

23. Gjithashtu, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të paanshmërisë*, me argumentin se gjyqtarja I.Gj. nuk ka zbatuar afatet procedurale të parashikuara nga ligji, pasi ka bërë një trajtim të ndryshëm të kërkesave të paraqitura nga kërkuesi në raport me kërkesat e paraqitura nga organi i akuzës. Sipas kërkuesit, opinioni i kësaj gjyqtareje ndryshon sipas opinionit juridik të prokurorisë, duke dëshmuar njëanshmërinë e saj dhe duke e vendosur kërkuesin në pozita procedurale jo të barabarta me organin e akuzës.

24. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjytimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata ka theksuar se respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet*

nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 23, datë 4.11.2008, të Gjykatës Kushtetuese). Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i bazuar (*shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë i ka kthyer përgjigje këtij pretendimi, duke arsyetuar se mënyra sesi disponon gjykata lidhur me çdo kërkesë të palëve gjatë procesit gjyqësor është objekt kontrolli nga gjykatat më të larta dhe nuk përbën shkak njëanshmërie. Po sipas saj, marrja e vendimeve nga gjyqtarët dhe menaxhimi i gjykimit prej trupit gjykues dhe kryesuesit janë shfaqje e çmuarjes dhe vlerësimit që i njihet gjyqtarit në gjykimin e çështjes, si shprehje e pavarësisë dhe paanësisë së tij. Gjykata konstaton se kërkuesi nuk ka arritur të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë të bindjes së brendshme që gjyqtarja ka krijuar në vlerësimin e informacionit të organit të akuzës dhe vijimin e zbatimit ndaj tij të masës së sigurimit personal. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se argumentet e kërkuesit për cenimin e këtij parimi, në drejtim të elementit *objektiv*, nuk janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ka pasur njëanshmëri të gjyqtarës së GJKKO-së së Shkallës së Parë në shqyrtimin e çështjes. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

27. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata, nisur nga fakti se vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi kanë dalë si rrjedhojë e detyrimit të prokurorisë për të paraqitur informacionin dymujor, si dhe nisur nga thelbi i pretendimeve të kërkuesit, do t'i analizojë ato në drejtim të së drejtës substanciale së lirisë personale, të parashikuar nga nenet 27 dhe 28, pika 3, të Kushtetutës, ndërsa pretendimet me natyrë procedurale si garanci në funksion të kësaj lirie themelore. Në këtë pikë Gjykata vë në dukje se me vendimin nr. 83/2024, ajo ka vlerësuar se caktimi i masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” ka qenë në përputhje me Kushtetutën.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë personale

28. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura prej tij për cenimin e të drejtave dhe lirive themelore, nuk kanë përmbushur detyrimin e verifikimit të gjendjes së hetimit, por janë kufizuar në listimin e veprimeve të prokurorisë dhe arsyetimet e tyre janë kontradiktore e të pakuptueshme, të përdorura edhe në caktimin e masës së sigurimit një vit më parë. Po sipas kërkuesit, gjykatat nuk i kanë kthyer përgjigje as pretendimeve për pavlefshmërinë e akteve të ekspertimit dhe nuk janë ndalur në ndonjë provë konkrete, por kanë përdorur shprehje standarde dhe një qëndrim formal, veçanërisht gjykata e apelit, e cila është mjaftuar me një paragraf në arsyetimin e saj. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se mungon fakti penal, pasi veprimet e kryera nga vjehri i tij janë veprime të parashikuara në Kushtetutë, konsiderohen akte kolegjiale dhe që janë kryer për shkak të detyrës që ai ka pasur si Kryetar i Këshillit të Ministrave. Po kështu, ai ka pretenduar se gjykatat nuk kanë dhënë argumente të mjaftueshme për nevojën e kohëzgjatjes së masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” dhe vazhdimin e kufizimit të lirisë personale dhe së drejtës për jetë familjare. Gjykatat nuk e kanë mbështetur arsyetimin e tyre në të dhënat që kanë rezultuar nga hetimi, pasi nga asnjë provë nuk rezulton përpjekja e vjehrit të kërkuesit për të ndikuar në procesin e marrjes së provave. Po sipas tij, gjykatat nuk kanë paraqitur arsye legjitime të mjaftueshme për vazhdimin e kufizimit të lirisë, në

drejtim të nevojshmërisë dhe proporcionalitetit të masës, në raport me fazën aktuale të procedimit dhe të dhënat e prokurorisë të vëna në dispozicion.

29. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se pretendimet e kërkuarit janë të pabazuara, pasi dyshimet e arsyeshme për kryerjen e veprës penale, që justifikojnë kufizimin e lirisë personale, nënkuptojnë ekzistencën e fakteve dhe informacioneve, të cilat nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato që justifikojnë dënimin penal. Sipas tij, Gjykata e Lartë e ndërlihd statusin e gjësë së gjykuar, për sa kohë nuk janë verifikuar ndryshimet e kushteve origjinare të zbatueshmërisë së masës së caktuar. Në rastin konkret, sipas subjektit të interesuar, nga gjykatat e të gjitha shkallëve është respektuar kriteri kushtetues i dyshimit të arsyeshëm, si kusht *sine qua non* për justifikimin e kufizimit të lirisë personale të kërkuarit, si dhe është arsyetuar mjaftueshëm në lidhje me plotësimin e kushteve të veçanta për caktimin e masës së sigurimit, rrezikut të ikjes së personit dhe rrezikut të ndërhyrjes së tij në marrjen e provave.

30. Neni 27 i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (paragrafi 1), ndërsa liria e personit mund të kufizohet kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale (paragrafi 2, shkronja “c”). Sipas jurisprudencës tashmë konstante të Gjykatës, qëllimi kryesor i këtij neni është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një “shoqëri demokratike”. Kërkesa “dyshime të arsyeshme” për kryerjen e veprës penale që justifikon kufizimin e lirisë personale të individit, nënkupton ekzistencën e fakteve ose të informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale, të cilat nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, që i përkasin një shkalle të mëvonshme të procesit të hetimit penal. Dyshimi konsiderohet i arsyeshëm për kufizimin e lirisë personale nëse bazohet në fakte dhe informacione, të cilat krijojnë bindjen se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprës penale për të cilën akuzohet. Po sipas Gjykatës, në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, rastet dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar nga KPP-ja, ku në rastin e caktimit të masës së sigurimit, neni 228, pika 1, i saj, në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, përcakton si kusht të domosdoshëm (*sine qua non*) ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individ ka kryer një vepër penale (*shih vendimet nr. 86, datë 20.12.2024; nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 19, datë 4.4.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në lidhje me masat e sigurimit personal të arrestit, sipas nenit 28, pika 3, fjalja e dytë, të Kushtetutës, i paraburgosuri ka të drejtë të gjykohe brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit. Këto garanci gjenden edhe në paragrafin 3 të nenit 5 të KEDNJ-së, sipas të cilit çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1, shkronja “c”, të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohe brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjykimit, lirim që mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t'u paraqitur në procesin gjyqësor.

32. Për sa më sipër, ndërsa neni 27, pika 2, shkronja “c”, i Kushtetutës dhe neni 5, paragrafi 1, shkronja “c”, i KEDNJ-së përcaktojnë arsyet mbi të cilat paraburgimi mund të jetë i lejueshëm, neni 28, pika 3, i Kushtetutës dhe neni 5, paragrafi 3, i KEDNJ-së përcaktojnë disa garanci procedurale, duke përfshirë rregullin që paraburgimi nuk duhet të kalojë një kohë të arsyeshme, duke rregulluar kështu kohëzgjatjen e tij.

33. GJEDNJ-ja ka pohuar se vijimi i një dyshimi të arsyeshëm është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e arrestit, por pasi kalon një kohë e caktuar, ai nuk mjafton më. Në këtë çështje,

GJEDNJ-ja duhet të verifikojë: a) nëse shkaqe të tjera të dhëna nga autoritetet gjyqësore vazhdojnë të justifikojnë heqjen e lirisë; b) nëse këto shkaqe janë “relevante” dhe “të mjaftueshme”. Shkaqet janë konsideruar “relevante” dhe “të mjaftueshme” (përveç ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm) në jurisprudencën e GJEDNJ-së, kur ekziston: a) rreziku që i akuzuari të mos paraqitet në gjyq; b) rreziku që i akuzuari, nëse lirohet, të ndërmarrë veprime për të dëmtuar administrimin e drejtësisë; c) rreziku që të kryejë vepra të mëtejshme penale; d) rreziku që të shkaktojë çrregullime publike (*shih Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DHM], 2016, § 88; Piruzyan kundër Armenisë, 2012, § 94*).

34. Çështja nëse një periudhë kohore e kaluar në paraburgim është e arsyeshme, nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte. Nëse është e arsyeshme që një i akuzuar të qëndrojë në paraburgim duhet të vlerësohet mbi faktet e secilit rast dhe sipas karakteristikave të tij specifike. Vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka tregues aktualë të një kërkese të vërtetë të interesit publik, i cili, pavarësisht prezumimit të pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale, të përcaktuar në nenin 5 të KEDNJ-së. Duke marrë parasysh veçanërisht rrezikun e arratisjes, duhet t’i kushtohet vëmendje karakterit të personit të përfshirë, moralit të tij ose të saj, pasurive, lidhjeve me shtetin në të cilin ai ose ajo po ndiqet penalisht dhe kontakteve ndërkombëtare të personit (*shih Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DHM], 2016, § 90*).

35. GJEDNJ-ja, gjithsesi, nuk e ka përcaktuar në jurisprudencën e saj fushëveprimin e shprehjes “kalim i caktuar kohor” dhe as nuk ka përcaktuar ndonjë kriter të përgjithshëm në këtë drejtim. Ajo nuk është përpjekur ta përkthejë këtë koncept në një numër të caktuar ditësh, javësh, muajsh ose vitesh, ose në periudha të ndryshme në varësi të seriozitetit të veprës penale (*shih Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DHM], 2016, § 92, 94*). GJEDNJ-ja, gjithashtu, duhet të sigurohet nëse autoritetet kompetente kombëtare kanë treguar “kujdesin e veçantë” në zhvillimin e procesit (*shih Gëllçi kundër Shqipërisë, datë 25.2.2025, § 19; Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DHM], datë 5.7.2016, § 87*).

36. Gjykata konstaton se në datën 20.10.2023, mbi kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë është vendosur masa e sigurimit “Arresti në burg”, e cila është ndryshuar nga GJKKO-ja e Apelit në masën e sigurimit “Arresti në shtëpi” në datën 21.11.2023. Kjo masë është lënë më pas në fuqi nga Gjykata e Lartë me vendimin e datës 5.3.2024. Gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë vlerësuar se përmbushen dy kushtet e para të përcaktuara nga neni 228 i KPP-së, ai për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova për kryerjen e veprave penale (*pika 1*) dhe ai për mungesën e shkaqeve të padënueshmërisë (*pika 2*), për sa i përket kushtit të tretë (*pika 3*) ekziston rreziku që kërkuesi të largohet për t’iu fshehur procedimit penal (*shkronja “b”*), por jo ai për të kryer krime të rënda ose të njëjta me ato për të cilat po procedohet (*shkronja “c”*). Këto vendime janë bërë objekt i kontrollit kushtetues nga Gjykata, e cila, me vendimin nr. 83/2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke vlerësuar se arsyetimi i gjykatave të zakonshme në funksion të ekzistencës së dyshimeve të arsyeshme për kryerjen nga kërkuesi të veprave penale nuk rezultonte arbitrar në këndvështrimin kushtetues. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të proporcionalitetit, si pjesë e aspektit substancial të lirisë personale, Gjykata, në kushtet kur nuk u formua shumica prej pesë gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, e konsideroi këtë pretendim të rrëzuar.

37. Ndërkohë, rasti objekt i këtij gjykimi kushtetues lidhet me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, e cila, bazuar në nenin 246, pika 6, të KPP-së, ka paraqitur pranë GJKKO-së së Shkallës së Parë informacionin me shkrim, si dhe provat e përfuara në kuadër të hetimit dymujor për kërkuesin, duke kërkuar vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”. Në

lidhje me këtë kërkesë, me vendimet objekt kundërshtimi, është vendosur vijimi i zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”.

38. Për sa më lart, në vijim, Gjykata do të analizojë nëse në rastin konkret gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm veprimet e kryera nga prokurori dhe të paraqitura në informacionin dymujor, pra nëse ky i fundit përbënte një informacion formal dhe të përgjithshëm apo ishte i detajuar në drejtim të forcimit ose zbehjes së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, si dhe kriteret dhe shkaqet për nevojën e vijimit të zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”.

39. Në rastin konkret, Gjykata vëren se sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, që ka marrë në shqyrtim informacionin dymujor të paraqitur nga Prokuroria e Posaçme, pas caktimit të masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, nga ana e organit të akuzës janë kryer veprime hetimore të cilat pasqyrojnë se është treguar *diligjenca e duhur në ushtrimin e ndjekjes penale*. Referuar pretendimeve të paraqitura nga organi i akuzës dhe veprimeve hetimore të kryera, është provuar se është treguar kujdes dhe janë bërë përpjekjet e duhura për të përmbushur në substancë qëllimin e veprimeve hetimore, në rrethanat që ka nisur procedimi penal. Po kështu, sipas gjykatës, që nga data e caktimit të masës fillestare të sigurimit dhe deri në datën e paraqitjes së informacionit dymujor nga ana e Prokurorisë së Posaçme, nuk rezulton të kenë ndryshuar kushtet për masën e sigurimit dhe nuk rezulton mospajtim i saj me kushtet e kriteret që kanë shërbyer për vendosjen e saj, si dhe nuk rezulton të kenë ndryshuar rrethanat e faktit e të ligjit. Në vlerësimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, nga ana e organit të akuzës janë kryer një sërë veprimesh hetimore, që nga pyetja e disa personave, të cilët kanë dhënë informacione të dobishme për hetimin dhe janë administruar një tërësi provash shkresore, siç janë: verifikimet e kryera pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve; administrimi i të dhënave nga Ministria e Drejtësisë që lidhen me ushtrimin e aktivitetit të noterës L.P. dhe sekuestrimi pranë kësaj të fundit të një sërë dokumenteve; administrimi i aktit të ekspertimit për pajisje elektronike. Ndërkohë nuk janë administruar një sërë aktesh të tjera, të cilat janë të pritje të analizës. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, nga analiza në tërësi e veprimeve hetimore, vijon të ekzistojë për kërkuesin “*dyshimi i arsyeshëm*” i bazuar në prova (*fumus cemmisi delicti*), kushti bazë për caktimin e masave të sigurimit (neni 228, pika 3, i KPP-së), se ai është autor i veprave penale për të cilat akuzohet. Po kështu, kjo gjykatë ka arsyetuar se nga hetimi i deritanishëm rezulton se *nuk ka ndryshim të kriterëve dhe të kushteve për të cilat është caktuar masa e sigurimit*, si dhe nuk rezulton që të jetë lehtësuar pozita e kërkuesit si i hetuar.

40. Po kështu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, lidhur me pretendimet e kërkuesit për kryerjen nga ana e organit të akuzës të veprimeve hetimore të përsëritura ose që nuk lidhen me veprat penale që u atribuohen të hetuarve, ka vlerësuar se ato janë të pabazuara. Sipas gjykatës, nga organi i akuzës u argumentua mbi arsyet për kryerjen e veprimeve hetimore respektive dhe lidhjen e tyre në substancë me kërkuesin dhe me veprat penale që i atribuohen. Më konkretisht, pyetja e dy shtetasve është bërë me qëllim zbardhjen e fakteve që kanë të bëjnë me shpërndarjen e produktit të veprës penale; pyetja e dy shtetasve të tjerë ka qenë e domosdoshme për vërtetimin e lidhjes së tyre me kërkuesin dhe rolin në zhvillimin e ndërtimeve; marrëdhëniet juridike civile duhet të hetohen, pasi nuk janë asnjëherë të zhveshura nga elementet penale; aktet e përpiluara nga noterja kanë lidhje me veprat penale për të cilat dyshohet kërkuesi. Për pretendimet për pavlefshmërinë e ekspertimit grafik, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nuk mund të disponojë në lidhje me këtë kërkim, për sa kohë çështja është në fazën e hetimit paraprak dhe ajo mund të bëhet në shqyrtimin në themel të çështjes. Po sipas kësaj gjykate, *vijojnë të ekzistojnë kushtet dhe kriteret dhe justifikohet vazhdimi i zbatimit të masës së sigurimit të caktuar ndaj kërkuesit, ndaj pretendimi i tij në këtë drejtim nuk është i bazuar*.

41. Në vijim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se, bazuar në kriteret e nenit 260 të KPP-së, nevojat e sigurimit vijnë të jenë në të njëjtin stad. Po kështu, duke pasur parasysh rrethanat që kanë të bëjnë me karakterin e personave nën hetim, *ndikimin që mund të kenë qoftë në institucione shtetërore, por edhe te dëshmitarët*, llojin e veprës penale që dyshohet të kenë kryer dhe sanksionet e larta që parashikohen për këto vepra penale, personalitetin e tyre, *lidhjet me persona me influencë*, si dhe duke marrë në konsideratë kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit personal, parë edhe në këndvështrim të jurisprudencës së GJEDNJ-së, për sa i përket diskutimit të *rrezikut të largimit*, në raport me faktin penal për të cilën ata dyshohen, çmon se këto rrethana vijnë të jenë ende prezente. Në përfundim, gjykata ka vlerësuar se nuk ka vend për revokimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” dhe nuk ka ndryshim thelbësor, në favor të personave nën hetim, të kushteve dhe të kriterëve të zbatimit të masës, në kushtet që janë thelbësore për revokimin ose zëvendësimin e masës. Po kështu, nga vazhdimi i hetimit nuk rezulton që të jetë lehtësuar pozita e kërkuesit.

42. Mbi ankimin e kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Sipas GJKKO-së së Apelit, vendimmarrja e GJKKO-së së Shkallës së Parë është e bazuar si në fakt dhe në të drejtë dhe nevojat e sigurimit të kërkuesit ose mbajtja nën kontroll paraprak e rreziqeve të mundshme të procedimit nga lënia në liri e tij apo pa masë sigurimi, *mbeten të pandryshuara ose të qëndrueshme*, njësoj si në kohën e caktimit të masës së sigurimit. Sipas asaj gjykate, referuar nenit 228, pika 3, shkronjat “a” dhe “b”, të KPP-së dhe vendimit nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023 të GJKKO-së së Apelit që ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, rreziku që mund të kanosë procedimin nga lënia në liri ose pa masë sigurimi është *“frika” se ai mund të largohet*, duke iu shmangur drejtësisë, që është aktual sikurse në gjenezë.

43. Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar se nevojat e sigurimit paraqiten të pandryshuara ose të qëndrueshme, pasi aktualisht nuk kanë ndryshuar rrethanat për të cilat në gjenezë është konkluduar se kërkuesi duhet të shtrëngohej me një masë personale sigurimi. Gjithashtu i qëndrueshëm dhe aktual rezulton edhe *rreziku i ikjes* së kërkuesit për t’iu shmangur drejtësisë, nisur nga dëshira natyrale për të ruajtur lirinë, në kushtet kur veprat penale, objekt dyshimi ndaj tij, parashikojnë dënime vetëm me burgim. Për këto arsye, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se qëndrueshmëria e rreziqeve që i vijnë procedimit penal nga liria/*periculum libertatis* e kërkuesit dhe bashkekzistenca e kushteve të tjera dhe kriterëve të zbatueshmërisë së masës ndaj tij, e bën kërkimin për revokimin ose heqjen e masës së sigurimit të pabazuar. Po kështu, sipas gjykatës, provat e ofruara nga Prokuroria e Posaçme në gjenezë dhe ato të paraqitura me informacionin dymujor janë të afta që të mbajnë në jetë dyshimin se kërkuesi është autor i mundshëm i veprave penale për të cilat akuzohet. Në këtë kuptim, provat e mbledhura në vijim të hetimeve paraprake nuk “tronditin” qëndrueshmërinë e parakushtit jetik për caktimin/vijimin e një mase sigurimi personal ndaj kërkuesit.

44. Në vijim, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se për pretendimet e kërkuesit për pavlefshmërinë relative të akteve ajo nuk ka diskrecionin për t’i shqyrtuar, pasi të tilla kërkime mund të ngrihen vetëm para gjykatës së seancës paraprake dhe gjykatës që shqyrton themelin e procedimit. Në përfundim, ajo gjykatë ka vlerësuar se organi i akuzës ka treguar diligjencën ose kujdesin e duhur në ushtrimin e ndjekjes penale dhe zhvillimin e hetimeve të këtij procedimi, si në numrin e veprimeve hetimore të kryera, ashtu edhe në rëndësinë e tyre.

45. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas tij, gjykatat më të ulëta e kanë argumentuar vendimmarrjen e tyre dhe u kanë dhënë përgjigje në thelb

shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi dhe arsyetimet e tyre janë plotësuese të njëra-tjetrës. Po sipas Kolegjit Penal, të dyja gjykatat kanë argumentuar mjaftueshëm edhe për ligjshmërinë e vazhdimit të zbatimit të masës të sigurimit personal ndaj kërkuesit, si dhe kanë analizuar kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligj për caktimin e saj në kuadër të informacionit dymujor të paraqitur nga Prokuroria e Posaçme. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, pretendimet lidhur me fuqinë provuese të provave të administruara ose panevojshmërinë e marrjes së provave të evidentuara nga Prokuroria e Posaçme gjatë shqyrtimit të informacionit dymujor, nuk përbëjnë shkak cenes ndaj vendimmarrjes objekt rekursi. Edhe për sa i përket pretendimit se është i gabuar vlerësimi i gjykatave që i kanë konsideruar gjë të gjykuar pretendimet e ngritura nga kërkuesi, Kolegji Penal ka vlerësuar se është i pabazuar.

46. Po kështu, në vlerësimin e Kolegjit Penal, deri në këtë fazë të procedimit, gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova (të përforduar me vijimin e hetimeve), se kërkuesi mund të ketë kryer veprat penale për të cilat hetohet. Edhe pretendimet për unifikimin/njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji Penal i ka gjetur të pabazuara. Në përfundim, ai ka vlerësuar se në vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural penal me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore apo me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve, papërdorshmërinë e provave, si dhe vendimi nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

47. Nga sa më lart, Gjykata vëren fillimisht se gjykatat kanë vlerësuar se si në momentin fillestar të caktimit të masës së sigurimit, ashtu edhe në vijim ekzistonte një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova relevante dhe të mjaftueshme, se kërkuesi ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, i cili justifikon interesin publik, që pavarësisht parimit të prezumimit të pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë personale.

48. Në analizë të vendimmarrjes së gjykatave të posaçme dhe Gjykatës së Lartë për informacionin dymujor të paraqitur nga Prokuroria e Posaçme, Gjykata konstaton se ato kanë analizuar në mënyrë konkrete nevojën për vijimin e masës së sigurimit, duke vlerësuar se rrethanat që justifikuan vendosjen fillestare të saj vazhdojnë të jenë të pranishme edhe në momentin e shqyrtimit periodik, si dhe Prokuroria e Posaçme ka treguar dilijencën e duhur në ushtrimin e ndjekjes penale dhe mbledhjen e provave të mëtejshme.

49. Në këtë drejtim, Gjykata evidenton se gjykatat kanë arsyetuar: i. kriterin e rrezikut të largimit, me qëllim shmangien e procedimit penal, pra rrezikut të arratisjes së kërkuesit, duke dhënë arsye se përse në këtë rast plotësohet kriteri i nenit 228 të KPP-së, shkronja “b”, pra se ekzistojnë arsye që justifikojnë dyshimin se kërkuesi mund të largohet ose të arratiset. Gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar; edhe ii. rrezikun e marrjes dhe manipulimit të provave, duke argumentuar në këtë drejtim se kërkuesi në rast se do të gjykohej i lirë ose në një masë tjetër më të lehtë sigurie, do të ndikonte ose pengonte procesin e të provuarit dhe vërtetimin e rrethanave të faktit të lidhura me procedimin penal, duke vënë kështu në rrezik dhënien e drejtësisë. Arsyetimi i gjykatave në këtë drejtim është i plotë, pasi ai evidenton edhe faktin se prokuroria nuk ka arritur të marrë të gjitha provat që lidhen me procedimin penal, duke mos u zbehur këssoj nevojat e sigurimit.

50. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se gjykatat e zakonshme nuk janë mjaftuar me një ripërsëritje automatike të arsyeve që kanë justifikuar vendosjen fillestare të masës së sigurimit, por kanë ushtruar një kontroll të përditësuar për domosdoshmërinë e vijimit të saj, çka përmbush kriterin kushtetues të vlerësimit prej gjykatave të zakonshme të nevojave të sigurimit në mënyrë të individualizuar. Në rastin konkret, informacioni dymujor i paraqitur nga prokuroria nuk është

trajtuar në mënyrë formale ose mekanike, por është analizuar si element i ri në funksion të këtij kontrolli periodik. Nga përmbajtja e vendimeve rezulton se gjykatat kanë kryer një vlerësim të mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese të veprimeve hetimore të ndërmarra gjatë periudhës përkatëse, duke evidentuar personat e pyetur, natyrën e deklarimeve të tyre dhe provat e administruara. Ky informacion është konsideruar si tregues i progresit real të hetimit dhe si element që vazhdon të mbështesë dyshimin e arsyeshëm ndaj kërkuesit.

51. Në këtë kuadër, Gjykata çmon se pas kalimit të një kohe nga vendosja fillestare e masës, gjykatat kanë verifikuar në mënyrë konkrete nëse rrethanat që e justifikuan atë vijnë në ekzistencë. Ato kanë arsyetuar se veprimet hetimore të pasqyruara në informacionin periodik jo vetëm që nuk e zbehin dyshimin e arsyeshëm, por e konsolidojnë atë. Po kështu, mungesa e përfundimit të hetimeve dhe natyra e provave të mbledhura janë vlerësuar si elemente që në këtë fazë procedurale e bëjnë ende të nevojshëm vijimin e masës së sigurimit, në përputhje me kriteret ligjore dhe me kërkesën për një arsyetim të vazhdueshëm dhe proporcional të kufizimit të lirisë personale.

52. Në kuptim të sa më sipër, duke pasur parasysh edhe objektin e procesit gjyqësor të kundërshtuar nga kërkuesi, që lidhet me informacionin dymujor në kuadër të procedimit penal të nisur ndaj tij, Gjykata vlerëson se shkaqet e dhëna nga gjykatat e posaçme dhe nga Gjykata e Lartë janë të mjaftueshme nga pikëpamja kushtetuese për të justifikuar vazhdimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit “Arresti në shtëpi”, ndaj vendimet e tyre përmbushin standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale është i pabazuar.

53. Në përfundim, Gjykata çmon se, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e pabazuar, ndaj ajo rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 15.1.2026.

Shpallur më 24.2.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Asim Vokshi

Anëtare kundër: Marjana Semini

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes, që i përket kërkuesit Jamarbër Malltezi, me objekt: “Shfuqizimi i vendimeve nr. 400, datë 30.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 172 (87-2024-248), datë 13.9.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; të vendimit nr. 00-2024-2076, datë 17.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, jam kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi, në vlerësimin tim, pretendimi i kërkuarit është i bazuar, për arsytet që do të parashtrihen në vijim.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e kësaj çështjeje rezulton se në kuadër të një procedimi penal për veprat penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të kryer në bashkëpunim dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 260 e 25 të KP-së dhe 287, paragrafi i dytë, i KP-së, ndaj kërkuarit është vendosur masa e sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, e cila është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë me vendimin e datës 5.3.2024. Pas këtij vendimi kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke pretenduar cenimin e lirisë personale në aspektin procedural dhe në aspektin substancial. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata, me vendimin nr. 83/2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ndërsa vlerësoi se pretendimet e kërkuarit për mungesën e dyshimit të arsyeshëm për kufizimin e lirisë personale të lidhura me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara, për sa i përket parimit të proporcionalitetit, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

3. Fillimisht, dua të sjell në vëmendje se në atë vendim kam mbajtur qëndrimin se gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar në nivelin kushtetues që kërkohet për të justifikuar masën kufizuese të lirisë ndaj kërkuarit, duke mos kryer një analizë të plotë të proporcionalitetit, nevojës dhe përshtatshmërisë së saj. Arsyetimi i GJKKO-së së Apelit për caktimin e masës “Arresti në shtëpi”, i mbështetur në dyshimin për kryerjen e veprës penale dhe në rrezikun e ikjes, rezulton i pamjaftueshëm, pasi nuk shoqërohet me një vlerësim konkret të elementeve faktike që provojnë këtë rrezik, të lidhura me rrethanat individuale të kërkuarit dhe me fazën e procedimit penal. Gjithashtu, gjykatat nuk kanë shqyrtuar as nëse një masë më pak kufizuese do të ishte e mjaftueshme për të garantuar mbarëvajtjen e procedimit ose për të shmangur cenimin e provave. Për rrjedhojë, kam vlerësuar se kjo mungesë arsyetimi përbën cenim të parimit të proporcionalitetit, në kuptim të elementit të nevojës dhe përshtatshmërisë, sipas nenit 17 të Kushtetutës.

4. Ndërkohë që ndaj kërkuarit ishte caktuar masa e sigurimit “Arresti në shtëpi”, në zbatim të nenit 246, pika 6, të KPP-së, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur në GJKKO-në e Shkallës së Parë informacionin dymujor me shkrim, në të cilin pasqyroheshin veprimet hetimore të kryera nga Policia Gjyqësore, si dhe ka kërkuar që masa e sigurimit të vazhdojë, ndërsa kërkuari ka kërkuar revokimin e saj. Në përfundim të shqyrtimit të këtij informacioni gjykatat kanë vendosur vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal, duke arsyetuar se nga ana e prokurorisë është treguar diligenca e duhur në ushtrimin e ndjekjes penale. Edhe ky proces gjyqësor është kundërshtuar nga kërkuari në Gjykatë, i cili ka pretenduar sërish cenimin e lirisë personale në aspektin procedural dhe substancial, me pretendimin kryesor se gjykatat nuk kanë paraqitur arsye legjitime të mjaftueshme për vazhdimin e kufizimit të lirisë së tij, në drejtim të nevojshmërisë dhe proporcionalitetit të masës, në raport me fazën aktuale të procedimit dhe të dhënat e prokurorisë të vëna në dispozicione informacionin dymujor.

5. Shumica ka vlerësuar se gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme si rrezikun e largimit, me qëllim shmangien e procedimit penal të kërkuarit, në kuptim të nenit 228, shkronja “b”, të KPP-së, ashtu edhe rrezikun e manipulimit të provave ose pengimit të mbarëvajtjes së procedimit penal. Sipas shumicës, gjykatat nuk janë mjaftuar me ripërsëritje

formale të shkaqeve të vendosjes fillestare të masës së sigurimit, por kanë ushtruar një kontroll të përditësuar dhe të individualizuar për domosdoshmërinë e vijimit të saj, duke analizuar informacionin periodik të prokurorisë, progresin konkret të hetimeve dhe provat e administruara. Shumica gjithashtu ka pranuar se hetimi mbetet aktiv dhe dyshimi i arsyeshëm jo vetëm që nuk është zbehur, por është konsoliduar dhe se në këtë fazë procedurale nevojat e sigurimit vijnë të ekzistojnë. Për rrjedhojë, sipas shumicës, arsyetimi i gjykatave është i mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për të justifikuar vazhdimin e masës “Arresti në shtëpi”, ndërsa pretendimi për cenimin e lirisë personale është vlerësuar i pabazuar (*shih paragrafët 49-52 të vendimit*).

6. Në ndryshim nga shumica çmoj se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale është i bazuar. Duke qenë se në qëndrimin tim të mëparshëm kam arritur në përfundimin se masa e sigurimit nuk duhej të ishte caktuar që në momentin fillestar, për shkak të mungesës së arsytimit të mjaftueshëm mbi nevojën dhe proporcionalitetin e saj, rrjedhimisht nuk mund të pajtohem as me vijimin e një mase që, në thelb, nuk përmbushte kushtet dhe kriteret për vendosjen e saj. Në këtë kuptim, shkaqet e dhëna nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk ishin të “mjaftueshme” për të justifikuar mbajtjen e kërkuesit nën masën “Arresti në shtëpi” për periudhën përkatëse prej 1 viti, 7 muajsh e 16 ditësh, nga data 21.11.2023 deri më 7.7.2025, kur është zëvendësuar masa e sigurimit nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë. Gjithashtu, dëshiroj të theksoj se vijimi i kufizimit të lirisë personale kërkon një kontroll rigoroz, të përditësuar dhe të individualizuar të rrethanave konkrete të çështjes, përtej referimit formal në shkaqet fillestare, në përputhje edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së për nenin 5 të Konventës.

7. Kështu, sipas GJEDNJ-së, deri në dënimin e tij personi i akuzuar duhet të prezumohet i pafajshëm dhe qëllimi i nenit 5 të KEDNJ-së është, në thelb, që ai të kërkojë lirinë e përkohshëm atëherë kur vijimi i paraburgimit pushon së qeni i arsyeshëm. Çështja nëse një periudhë kohore e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte, por në bazë të fakteve të secilit rast dhe veçorive të tij specifike. Prandaj, vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka tregues specifikë të një kërkese të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale të përcaktuar në nenin 5 të KEDNJ-së (*shih guidën e nenit 5 të KEDNJ-së “E drejta për liri dhe siguri”, §§ 205, 206*).

8. GJEDNJ-ja ka pohuar edhe se vijimi i një dyshimi të arsyeshëm është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e arrestit në burg, por nuk mjafton më pasi kalon një kohë e caktuar. Në këtë rast gjykata duhet të verifikojë nëse shkaqe të tjera të dhëna nga autoritetet gjyqësore vazhdojnë të justifikojnë heqjen e lirisë. Nëse këto shkaqe janë “relevante” dhe “të mjaftueshme”, Gjykata duhet të sigurohet nëse autoritetet kompetente kombëtare kanë treguar “kujdesin e veçantë” në zhvillimin e procesit (*shih Gëllçi kundër Shqipërisë, datë 25.2.2025, § 19; Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DHM], datë 5.7.2016, §§ 84-91, 102*).

9. Në referim të sa më sipër, vlerësoj se në rastin konkret, për sa i përket kriterit të rrezikut të marrjes dhe manipulimit të provave, gjykatat e zakonshme, ndonëse kanë evidentuar veprimet e prokurorisë dhe lidhjen që ato kanë me hetimin, nuk kanë paraqitur argumente të mjaftueshme në këtë drejtim, pra se kërkuesi në rast se do të gjykohej i lirë ose në një masë tjetër më të lehtë sigurie, do të ndikonte, pengonte, ngadalësonte ose devijonte në mënyrë të parregullt procesin e të provuarit dhe vërtetimin e rrethanave të faktit të lidhura me procedimin penal. Në vlerësimin tim, arsyetimi i gjykatave në këtë drejtim është i përgjithshëm, duke mos u evidentuar provat konkrete ose indiciet mbi të cilat bazohet dyshimi se kërkuesi mund të ndikonte në procesin e marrjes/mbledhjes së provave. Argumentet e gjykatave detajohen kryesisht për të hetuarin tjetër, S.B., dhe mundësinë e manipulimit të provave për shkak të pozitës dhe lidhjeve të tij, ndërsa

kërkuesi përmendet prej tyre në mënyrë të përgjithshme, duke mos detajuar përpjekjet e tij për të manipuluar provat ose dëshmitarët. Për më tepër, gjykatat nuk kanë identifikuar në mënyrë konkrete se cilat prova specifike mund të manipuloheshin ose helmoheshin nga kërkuesi dhe që ende nuk ishin administruar, si dhe nuk kanë arsyetuar përse këto prova nuk mund të siguroheshin në një fazë më të hershme të hetimit. Në konkluzion të këtyre fakteve dhe rrethanave, gjykatat nuk duket të kenë vlerësuar ndonjë masë sigurimi alternative përtej deklarimeve të thjeshta formale të tyre, pavarësisht kërkesave të kërkuesit.

10. Edhe për sa i përket kriterit të rrezikut të largimit, me qëllim shmangien e procedimit penal, pra rrezikut të arratisjes së kërkuesit, jam e mendimit se gjykatat nuk kanë dhënë arsye që justifikojnë dyshimin se kërkuesi mund të largohet ose të arratiset. Për më tepër, nuk rezulton asnjë e dhënë ose fakt që të vërtetojë rrezikun e largimit të kërkuesit dhe mospërballjes së tij me procesin penal. Ndërsa GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka argumentuar rrezikun e largimit duke e lidhur vetëm me faktin penal, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar me një gjuhë shumë të përgjithshme se rreziku i ikjes lidhet me dëshirën natyrale për të ruajtur lirinë. Në këtë kuptim, gjykatat nuk kanë argumentuar për cilësitë individuale, personalitetin dhe karakterin e kërkuesit, profesionin, pasuritë ose lidhjet familjare të tij dhe si ato ndikojnë në rrezikun e largimit të tij dhe shmangien nga procedimi penal.

11. Në këtë këndvështrim vlerësoj se për sa kohë kriteret e mësipërme nuk janë analizuar nga gjykatat e zakonshme, duke mos i verifikuar ato me rastin konkret, vendimet e tyre konsiderohen me argumente të përgjithshme dhe që nuk përmbajnë fakte konkrete të cilat do të justifikonin vijimësinë e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”. Nisur nga fakti se nga procesi gjyqësor për rishikimin e masave të sigurimit personal cenohet një e drejtë substanciale, siç është liria personale, nuk mjafton trajtimi i kushteve dhe kriterëve që ka bërë vendimi i mëparshëm që ka caktuar masën e sigurimit personal, por ato (kushtet dhe kriteret) duhet të analizohen dhe arsyetohen edhe në rastin e rishikimit të tyre.

12. Për sa më sipër, ritheksoj se mbetem e qëndrimit se masa e sigurimit personal “Arresti në shtëpi” e vendosur ndaj kërkuesit nuk duhej të ishte caktuar që në momentin fillestar, ndaj nuk mund të pajtohem as me vijimin e saj. Një masë sigurimi që nuk përmbush standardet e nevojës dhe proporcionalitetit në momentin e caktimit, nuk mund të legjitimohet përmes vazhdimit formal të saj. Për më tepër, vlerësoj se gjykatat nuk kanë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe bindëse për nevojën aktuale të vijimit të kësaj mase, duke mos qartësuar nëse ekzistojnë rrethana të reja që e zbehin ose e forcojnë dyshimin e arsyeshëm në lidhje me rrezikun e largimit ose të ndikimit në prova. Mungesa e një analize të tillë konkrete mbi ekzistencën e nevojave të sigurimit e bën të pajustificuar, nga pikëpamja kushtetuese, kufizimin e mëtejshëm të lirisë personale të kërkuesit.

13. Në përfundim, për të gjitha argumentet e lartpërmendura, vlerësoj se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale ishte i bazuar, ndaj ankimi kushtetues individual i tij duhej të pranohej.

Anëtare: Marjana Semini